

Bordi i Administrimit i Universitetit Bujqësor të Tiranës

Nr.	Emër Mbimër	Funksioni	Emërimi
1.	Arta Dollani	Kryetar	
2.	Edmond Kadiu	Anëtar	Pedagog pranë FEA-së
3.	Blerina Duka	Anëtar	
4.	Ilir Kusi	Anëtar	Pedagog pranë FMV-së
5.	Matilda Shabani	Anëtar	Përfaqësues i MA-së
6.	Altin Prenga	Anëtar	
7.	Albert Kopali	Anëtar	Pedagog pranë FBM-së

1. Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij sipas pikës 1, të nenit 38, të Ligjit 80/2015, përgjegjës për përmbushjen e misionit të UBT-së. Senati akademik i UBT-së përcakton politikat e zhvillimit të UBT-së, programon dhe bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
2. Senati akademik i UBT-së kryesohet nga Rektori dhe mbledhet periodikisht.
3. Funksionet kryesore të Senatit Akademik janë:
 - garanton autonominë universitare, lirinë akademike, mundësitë e barabarta si dhe të drejtat e studentëve;
 - propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
 - harton strukturën e përgjithshme të UBT-së në bashkëpunim me njësitë bazë dhe kryesore të tij dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit të UBT-së në të gjitha nivelet;
 - miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të UBT-së;
 - krijon dhe garanton funksionimin e komisioneve të përhershëm në nivel universiteti, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - për zgjedh anëtarët e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ);
 - akordon titujt “Profesor Emeritus” dhe “Doktor Honoris Causa” sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e UBT-së;
 - miraton programin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore të rëndësishme të UBT-së;
 - miraton rregulloret e UBT-së dhe akteve të tjera institucionale; miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimeve si dhe mbylljes së tyre, kur ato janë të

mbështetura në projekt-buxhetin vjetor të UBT-së;

- miraton ndryshimet profilizuese për programe studimi të akredituara deri në masën 20% dhe njofton ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik;
- propozon mbylljen dhe riorganizimin e UBT-së si dhe ndarjen ose bashkimin e tij me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
- garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në UBT;
- zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit të UBT-së;
- miraton formatin e diplomave ose certifikatave të lëshuara nga UBT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
- miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit; ;
- miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të UBT-së mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë në përfundim të vitit akademik duke marrë gjithmonë vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
- miraton tarifat e shkollimit për vitin në vijim;
- miraton numrin minimal dhe maksimal të studentëve për çdo program studimi të ofruar në UBT, si edhe kriteret e pranimit në to;
- miraton kriteret për trajtimin e veçantë të studentëve në UBT;
- miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UBT-së, të hartuar nga rektorati dhe ia përcjell atë MASR-së;
- krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- miraton hapjen e filialeve, krijimin e qendrave apo kurseve të posaçme si dhe projekteve të tjera të shërbimit që ofrohen nga fakultetet;
- sipas propozimeve të departamenteve dhe fakulteteve, konfirmon kriteret e pranimit për të gjitha programet dhe ciklet e studimeve, si dhe kuotat përkatëse dhe ia propozon MASR;
- miraton vendosjen e marrëdhënieve në nivel kombëtar e ndërkombëtar të propozuar nga fakultetet;
- cakton komisionet e zgjedhjeve në shkallë universiteti;
- përmes një procesi vetëkandidimi, Senati i UBT-së zgjedh anëtarët e Komisioneve të Përhershme dhe të Këshillit të Etikës;
- organizon mbledhjen e përbashkët në bashkëpunim me Bordin e Administrimit në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimtarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare.

4. Senatit akademik të UBT-së përbëhet nga 25 anëtarë si më poshtë:

- Rektori, i cili është edhe kryetari i tij

-21 anëtarë nga stafi akademik si më poshtë:

- FEA 5 anëtarë staf akademik
- FBM 5 anëtarë staf akademik

- FMV 4 anëtarë staf akademik
 - FSHP 3 anëtarë staf akademik
 - FBU 3 anëtarë staf akademik
 - IRGJB 1 anëtar staf kërkimor-akademik
- dhe 3 përfaqësues nga trupa studentore e Universitetit
 - Senati akademik përpara zhvillimit të zgjedhjeve të radhës mblidhet dhe përcakton numrin e anëtarëve dhe strukturën e Senatit të ardhshëm të përbërë nga personel akademik dhe studentë.
 - Në rast se gjatë votimit rezultati është i barabartë dhe votimi nuk ka qenë i fshehtë, atëherë vota e Rektorit është vendimtare. Në çdo rast tjetër bëhet rivotim.
5. Administratori i UBT-së merr pjesë në mbledhjet e Senatit Akademik pa të drejtë vote.
 6. Dekani/Drejtori i njësisë kryesore, nëse nuk është zgjedhur anëtar senati, merr pjesë në çdo mbledhje të Senatit Akademik pa të drejtë vote.
 7. Anëtarët e Senatit zgjidhen nga asamblетë e personelit akademik të njësisë kryesore përmes një votimi të përgjithshëm për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.
 8. Anëtarët e Senatit i përkasin kategorisë “Profesor” ose “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve të huaja, anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve akademike të atyre kategorive mund të zgjidhen edhe ata që kanë gradën shkencore “Doktor” të fituar në Republikën e Shqipërisë, të kategorisë lektor.
 9. Senati akademik ka sekretarinë e tij që bën zbardhjen e vendimeve të Senatit. Detyrat e tjera të sekretarisë të Senatit Akademik përcaktohen në rregulloren e tij.
 10. Mandati i anëtarit të Senatit Akademik në UBT mbaron kur:
 - a) përmbushet afati i mandatit;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) largohet nga UBT;
 - d) bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë funksionin;
 - e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - f) kur janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit dhe të kodit të etikës, konstatuar nga Këshilli i Etikës së UBT-së;
 - g) në rastet kur studenti i zgjedhur në Senatin Akademik përfundon studimet universitare ose humbet statusin e studentit. Në këtë rast, ai zëvendësohet me kandidatin pasardhës në renditje, për nga numri i votave të grumbulluara në zgjedhjet e fundit deri në përfundim të mandatit të nisur.
 11. Vendi i mbetur bosh plotësohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
 12. Senati Akademik mblidhet në seanca të zakonshme çdo 2 muaj. Në fillim të çdo viti akademik publikohet programi i tij i punës. Ai mund të mblidhet edhe në seanca të jashtëzakonshme me nismën e Kryetarit të tij ose me kërkesën e të paktën një të tretës (1/3) së anëtarëve të tij por në çdo rast drejtohet nga kryetari i Senatit. Rendi i ditës propozohet nga kryetari i Senatit dhe

miratohet nga anëtarët e tij. Në rastet kur Senati mbledhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së anëtarëve, rendi i ditës propozohet nga ky grup anëtarësh dhe miratohet nga anëtarët e senatit. Vendimet e senatit janë të vlefshme vetëm kur në votim kanë marrë pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur me ligj kërkohet shumicë e cilësuar. Rregullat mbi procedurën e votimit dhe çështje të tjera që lidhen me të, përcaktohen në rregulloren e Senatit.

13. Në rast pamundësie objektive për të drejtuar mbledhjen kryetari i Senatit, zëvendësohet përkohësisht, nga anëtari më i vjetër në detyrë, me të drejtë vote. Në rastet kur anëtari me të drejtë vote ka shërbyer si anëtar për një periudhë të njëjtë kohe, zëvendësimi i përkohshëm do të bëhet përkatësisht nga anëtari më i vjetër në moshë
14. Senati akademik i UBT-së në ushtrimin e funksionit të tij merr vendime.
15. Vendimet e Senatit Akademik bëhen publike.

Neni 15

Bordi i Administrimit

1. Bordi i Administrimit (BaUBT) është organi më i lartë kolegjal administrativ i UBT-së, i cili garanton përmbushjen e misionit të UBT-së, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.
2. BaUBT ka këto funksione kryesore:
 - a) garanton qëndrueshmërinë financiare të UBT-së dhe përmbushjen e misionit të tij;
 - b) vlerëson paraprakisht mbylljen dhe riorganizimin e UBT-së, si dhe ndarjen ose bashkimin e UBT-së me një institucion tjetër të arsimit të lartë;
 - c) miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse të UBT-së;
 - d) jep mendim për projekt-rregulloren e UBT-së dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - e) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron UBT nga ushtrimi i veprimtarive të tij, si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - f) është përgjegjës për caktimin e kritereve e të procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ, mbështetur në aktet e institucionit të arsimit të lartë;
 - g) emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit;
 - h) miraton paraprakisht statutin e UBT-së, para se t'i përcillet Senatit Akademik. Ky vendim i BaUBT, merret me jo më pak se tre të pestat (3/5) e votave të anëtarëve të tij;
 - i) miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së UBT-së, të hartuar nga rektorati.
 - j) miraton rregulloren për administrimin, financat dhe kontabilitetin;
 - k) miraton kartën e auditit financiar të UBT-së, vjetor dhe planin strategjik dhe si edhe programet e angazhimit;
 - l) siguron që Administratori të informohet me raportet vjetore të auditimit të brendshëm të njësisë për mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e tij dhe hartimit të deklaratës vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - m) ngre komisione e grupe pune për çështje dhe veprimtari të veçanta;
 - n) miraton shpërblimin e anëtarëve të komisioneve të përhershme, komisioneve të zgjedhjeve në UBT, komisioneve të përkohshme, anëtarëve të Senatit dhe Bordit pas propozimit të Administratorit dhe miratimit nga Senati, si dhe trajtimin e veçantë financiar për personelin akademik, personelin ndihmës-akademik dhe administrativ të vlerësuar shumë mirë;
 - o) miraton fondet për realizimin e projekteve të ndryshme kërkimore-shkencore mbi bazën e propozimeve të Rektoratit;
 - p) përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron UBT nga ushtrimi i veprimtarive të tij si dhe mbikëqyr përdorimin e burimeve të financimit.
 - q) është përgjegjës për caktimin e kritereve dhe procedurave për punësimin e administratorëve dhe personelit administrativ mbështetur në statutin e UBT-së.

BaUBT me propozim të Senatit akademik miraton:

- a) planin strategjik të zhvillimit të UBT-së dhe mbikëqyr zbatimin e tij;

- b) buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të UBT-së dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
 - c) numrin e personelit në të gjitha nivelet;
 - d) miraton tarifat e studimit dhe të regjistrimit për çdo program studimi në UBT;
 - e) miraton tarifat e shërbimeve ndaj të tretëve;
 - f) miraton listat e studentëve që përjashtohen apo përfitojnë nga përjashtimi i tarifave në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - g) përcakton pagat dhe masën e shpërblimeve të personelit të UBT në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
3. BaUBT përbëhet nga shtatë anëtarë të punësuar me kohë të pjesshme. Numri i anëtarëve të BaUBT-së që përfaqësojnë UBT-në përkundrejt numrit të anëtarëve të tij dhe që përfaqësojnë ministrinë përgjegjëse për arsimin e lartë, qeverisjen vendore si edhe donatorë të tjerë të mundshëm, varet nga përqindja e kontributit financiar në buxhetin e UBT-së sipas përcaktimeve të kornizës ligjore në fuqi.
4. Rektori i UBT-së është i ftuar të marrë pjesë në mbledhjet e BaUBT pa të drejtë vote.
5. Niveli i kontributit financiar në buxhetin e UBT-së nga ana e ministrisë, qeverisjes vendore, donatorëve të tjerë të mundshëm dhe vetë UBT-së bazohet në planin buxhetor afatmesëm të tij, me marrëveshje midis palëve të sipërpërmendura. Ky plan përditësohet çdo vit dhe në fund të vitit të tretë financiar, bëhet rivlerësimi i financimit dhe përcaktimi i pjesëmarrjes së kontribuesve në Bordin e Administrimit.
6. Drejtuesit e njësive kryesore, drejtuesit e njësive bazë dhe administratorët nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit, por mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote.
7. Mandati i anëtarit të BaUBT përfundon kur:
- përfundon mandati;
 - jep dorëheqjen;
 - institucioni emërues ose zgjedhës e shkarkon në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
 - kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrojë detyrën;
 - bëhet ndryshimi i raporteve të përfaqësimit në BaUBT.
8. Shkarkimi i anëtarëve të BaUBT dhe përfaqësuesve të UBT, bëhet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë me propozimin e SaUBT.
9. Propozimin për shkarkim të përfaqësuesve të UBT-së në BaUBT e bën Senati Akademik. Rektori i UBT-së i përcjell për miratim ministrit përgjegjës për arsimin e lartë propozimin për shkarkim të përfaqësuesve të UBT-së në BaUBT.
10. Në rast mbarimi të parakohshëm të mandatit të autoriteteve dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve, mandati i anëtarit të ri të zgjedhur të organit drejtues është plotësues. Mënyra e thirrjes së mbledhjeve, rendi i ditës, pjesëmarrja, shumica për marrjen e vendimeve dhe çështjet e tjera të lidhura me to, parashikohen në rregulloren e brendshme të BaUB

Neni 16

Rektorati

1. Rektorati në UBT është organ kolegjal që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga:
 - a) Rektori;
 - b) Zëvendësrektorët;
 - c) Administratori i institucionit;
 - ç) Drejtuesit e njësive kryesore.
 - d) Autoritete të tjera
2. Numri i Zv. Rektorëve në UBT propozohet nga Rektori në përputhje me politikat mandatore të institucionit, por jo më shumë se 3 (tre).
3. Zv. Rektorët janë anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve të huaja, anëtare të OECD-së ose BE-së.
 - a) Ata emërohen dhe shkarkohen nga Rektori, pas miratimit në Senatin Akademik.
4. Rektorati harton planin strategjik të zhvillimit të UBT-së, mbështetur në propozimet e njësive bazë dhe kryesore të UBT, si dhe ato të administratorëve të tyre.
5. Rektorati ka këto funksione kryesore:
 - a) harton programin vjetor të veprimtarive akademike të UBT-së si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në Senatin Akademik;
 - b) propozon prioritetet për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore dhe ia paraqet ato Administratorit të UBT-së;
 - c) shqyrton projekt-buxhetin e hartuar nga Administratori i UBT-së para miratimit të tij në Senatin Akademik;
 - d) jep mendim për marrëveshjet me karakter akademik;
 - e) paraqet rekomandime për projektet, programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - f) propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të UBT-së për të gjitha nivelet;
 - g) shqyrton rregulloret e njësive kryesore.
6. Rektorati raporton një herë në vit realizimin e planit të veprimtarive të UBT-së para Senatit Akademik dhe BaUBT.
7. Rektorati harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe ia paraqet atë për miratim Senatit akademik dhe BaUBT, brenda muajit janar të vitit pasardhës.
8. Rektorati shqyrton raportin vjetor të veprimtarisë financiare para miratimit të tij në Senatin akademik dhe BaUBT.
9. Detyra dhe funksione të tjera të Rektoratit përcaktohen në Rregulloren e Rektoratit të UBT-së

